



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 410/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Jelena Stojanović përfaqësuesja e Komunës së Graçanicës, paraqitur kundër subjekteve të ndryshme politike, për shkak të vendosjes banerëve dhe posterave mbi rrugët publike, në seancën e panelit të mbajtur me 04.11.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Hidhet** si e parregullt ankesa e Komunës së Graçanicës,

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datën 31.10.2013, nga komuna e Graçanicës në të cilën thekson se në komunën e Graçanicës dhe në rrugën e sajë kryesore janë vendosur posterat e subjekteve politike dhe në këtë rast ato janë vendosur në mënyrë jo të rregullt e cila ka të bëjë me ceradë, mbulojë e cila është vendosur nga te dy anët e rrugës dhe është e ngjitur ne dy shtyllat të rrymës dhe ndriçimit dhe se cerada është e vendosur shume ulet dhe se gjate lëvizjes se kamionëve dhe autobusëve mund te vjen deri tek shqyerja e ceradës. Këto reklama sipas parashtruesit te ankesës është e vendosur ne rrugët kryesore dhe me te frekuentuara ne fshatin Shushice. Parashtruesi i ankesës thekson se për këtë çështje është informuar edhe stacioni policor në Graçanicë

PZAP-i, pasi që shqyrtoj rregullsinw e ankesës gjeti se:

**Ankesa është e parregullt**

PZAP-i, konstaton se ankesa e paraqitur nga përfaqësuesja e Komunës së Graçanicës Jelena Stojanović është e parregullt pasi që parashtruesi i ankesës nuk ka cekur në ankesë ndonjë kryesit te supozuar të shkeljes për të cilat pretendohet ne ankws, por vetëm theksohet se në rrugët e Komunës së Graçanicës janë të vendosura posterat të subjekteve politike pa treguar dhe pa i precizuar në mënyrë të çart se tw kujt janë ata postera për të cilat pretendohet në ankesë dhe se nga kush janë vendosur ato, andaj PZAP-i në mbështetje të nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në mbështetje të nenit 118.1 të LZP-së vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 410/2013 më datën 04.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Nehat Idrizi**

***Këshillë Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*